



A.nr.171/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.171/2026, të datës 16.02.2026, të parashtruar nga ankuesi S.N, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 09.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.171/2026, e datës 16.02.2026, e parashtruar nga ankuesi S.N, ashtu që, *detyrohet* Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën me numër protokolli 13/2025 të datës 12.08.2025 dhe kërkesën me numër protokolli 14/2025 të datës 26.08.2025 të parashtruara nga ankuesi, duke nxjerr akt administrative në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, S.N. (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 13.02.2023, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar më datë 16.02.2026, kundër mos veprimet të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me mos zbatimin në tërësi të Vendimit A.nr.1815/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit më datë 25.02.2026, ka përcjell përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë, ekziston baza ligjore që të detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës me numër protokolli 13/2025 të datës 12.08.2025, dhe kërkesës me numër protokolli 14/2025 të datës 26.08.2025 të parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Ndryshimit të Aktit të Emërimit me numër protokolli 979, të datës 14.12.2018, mbanë pozitën Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

- Ankuesi më datë 28.07.2025, 12.08.2025 dhe 26.08.2025, ka parashtruar kërkesë tek u.d. Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke kërkuar kompensimin e orëve shtesë, jashtë orarit të punës dhe kujdestarisë.

-Për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit në raport me kërkesat e tij, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit me Vendimin A.nr.1815/2025 të datës 19.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të shqyrtoj kërkesën me Nr. 09/2025 të datës 29.07.2025, ndërsa sipas arsyetimit të këtij vendimi obligimi ka qenë të shqyrtohet edhe kërkesa e datës 26.08.2025.

- Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 11.02.2026, ka shqyrtuar kërkesën e datës 29.07.2025 të ankuesit duke e aprovuar të njëjtën dhe duke njohur ankuesit kompensimin e orëve shtesë, jashtë orarit zyrtar, ndërsa sa i përket kërkesës së datës 26.08.2025, arsyetimi ka qenë që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk posedon një kërkesë të tillë.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk ka zbatuar në tërësi Vendimin A.nr.1815/2025 të KPMSHCK-së, sepse nuk ka shqyrtuar kërkesën e datës 26.08.2025, ndërsa, lidhur me kërkesën e datës 12.08.2025, që nuk është përmendur në vendimin e KPMSHCK-së, ka qenë vetëm një gabim teknik, andaj ka qenë obligim të shqyrtohen edhe këto dy kërkesa. Kërkesat i kam dërguar dhe janë të protokolluar dhe organi i punësimit ka qenë i obliguar të vendos ose të kërkon kopjet e kërkesave por nuk kanë qenë të gatshëm t'i shqyrtojnë ato. Kërkon që të konstatohet se është zbatuar pjesërisht vendimi, të obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MPB-së për shqyrtimin e kërkesës së datës 12.08.202 dhe 26.08.2025.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në shqyrtim të çështjes konkrete të ankuesit, ka marr parasysh pretendimet ankimore të ankuesit dhe ka konstatuar se në bazë të provave materiale ankuesi kërkesat e tij gjegjësisht atë të datës 12.08.2025 dhe 26.08.2025, i ka adresuar tek u.d. Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të dy kërkesat mbajnë edhe vull të protokollit zyrtar të kësaj ministrie, po ashtu, në ankesën e datës 20.10.2025 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi ka kërkuar që të obligohet institucioni të shqyrtoj kërkesat e datës 28.07.2025, 12.08.2025 dhe 26.08.2025, kurse sipas Vendimit Anr.1815/2025 të KPMSHCK-së, është përvjedhur një gabim teknik duke mos u përmendur fare kërkesa e datës 12.08.2025.

Ndërlidhur me rregullat dhe veprimet procedurale të një organi publik, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht: nenit 10, paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes*, andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore në raport me kërkesave të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesat e ankuesit dhe të njëjtit t'i lëshoj akt administrim brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98, paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99, paragrafi 1, të LPPA-së.

Kështu që, thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të ndërmarr të gjitha veprimet juridike-administrative si në arsyetim të këtij vendimi, në mënyrë që kërkesat e ankuesit të datës 12.08.2025 dhe 26.08.2025, të shqyrtohen në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht, nëse njësia përgjegjëse nuk posedon këto kërkesa të njëjtat të kërkojnë nga pala ankuese.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.171/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.N;
- Ministrinë e Punëve të Brendshme: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.